

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR TË MITUR, në trupin gjykues për të mitur i përbërë nga kryetarja e trupit gjykues për të mitur, Nushe Kuka Mekaj- gjyqtare, si dhe gjyqtarëve porotë Nexhmedin Basha dhe Afërdita Kërveshi, anëtarë të trupit gjykues për të mitur, me sekretaren juridike Fitore Bojku, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit, S.B, nga P., për shkak të veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 235, par.1, nënpar.1.1, të KP-së dhe veprës penale keqpërdorim seksual i personave me çrregullime, ose paaftësi mendore, apo emocionale, nga neni 234 par.1, të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PP/l.nr.322/14, të dt.19.1.2015. ne seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 27.04.2015, në prezencën e Prokurores së Shtetit-Valbona Haxhosaj, të akuzuarit S B, mbrojtësit i tij av. G. K., përfaqësuesit të ZMNV-së, Demë Hasanaj dhe të dëmtuarit A S, në të njëjtën ditë bie dhe shpall, ndërsa me dt. 30.04.2015 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

S. B i biri i R, i nënës H, e gjinisë K, i lindur me, në Pejë, ku edhe banon në rr. “”, nr. 70, ka të kryer, drejtimi i identifikuar në bazë dokumentit identifikues me nr. pers., të lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, i martuar, baba i ... fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në arrest shtëpiak që nga dt. 3.11.2014, e tutje.

SHPALLET FAJTOR

Për shkak se

1. Me dt.25.9.2014, rreth orës 19.42 minuta, në Pejë, në “.....”, në lokalit të tij, me dashje ka kryer akt seksual me të miturin nën moshën ... vjeç, M.I. nga P., në atë mënyrë që pasi i dëmtuari kishte hyrë në lokalit të pandehurit, ky i fundit fillimisht e ka shërbyer me një cigare dhe me pije energjike dhe më pas të miturit i ka lëshuar film me përmbajtje pornografike, ashtu që i pandehuri më pas me të miturin ka kryer marrëdhënie seksuale.

- me çka ka kryer vepër penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 235 par.1, pika 1.1 të KPRK.

2. Që nga periudha kohore e vitit 2013, e më tutje, në Pejë, në “.....”, në lokalin e tij, me dashje detyron personin me aftësi të zvogëluar mendore, ose fizike, ose me çrregullime apo paaftësi mendore apo emocionale, në akt seksual, duke e shfrytëzuar aftësinë e zvogëluar, në atë mënyrë që pasi i dëmtuari A S i kishte kërkuar të pandehurit një cigare, ky i fundit fillimisht e kishte shërbyer me një cigare dhe një pije energjike, më pas të njëjtin e fton në dyqanin e tij, ia lëshon një film pornografik, ashtu që gjatë shikimit të filmit, i pandehuri kryen seks oral dhe anal me të dëmtuarin në fjalë, të cilit për këto veprime ia ka dhënë 2 deri 3 euro.

- me çka ka kryer veprën penale keqpërdorim seksual i personave me çrregullime mendore, ose paaftësi mendore, apo emocionale, nga neni 234 par.1, të KPRK.

Konform nenit 80 par 1 të KPRK, të akuzuarit i

Përcaktim

Për veprën penale nën pikën 1. të dispozitivit të aktgjyqimit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite.

Për veprën penale nën pikën 2. të dispozitivit të aktgjyqimit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite.

Gjykata duke u bazuar në nenin 7, 41, 43 par.1 pika 1.2, 45,73,74 par.3, pika 3.10,3.11, lidhur me par.1,75 par.1, pika 1.2, 76 par.1, pika 1.2 80,83, 235 par.1, pika 1.1, neni 234 par.1, të KPRK-së, nenit 365, 366, 367 par.1 pika 1.1, 450, 463 të KPPRK-së, të akuzuarin e,

GJYKON

Me dënim burgu unik në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt.03.11.2014, e tutje.

OBLIGOHET i akuzuari që ë emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës ti paguaj shumën prej 200 (dyqind) €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjyqimi të merr formën prerë.

Të dëmtuarit A S dhe i mituri M.I. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Kundër të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit, i vazhdohet masa e arrestit shtëpiak, gjer në plotfuqishmërinë e aktgjykimit por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë -Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit kundër të akuzuarit S B, nga Peja, për shkak të veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 235, par.1, nënpar.1.4, të KP-së, veprës penale ofrim i materialit pornografik, personave nën moshën 16 vjeç nga neni 237 par.1, të KP-së dhe veprës penale keqpërdorim seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale, nga neni 234 par.1, të KP-së.

Procedura gjyqësore është zhvilluar konform dispozitës së nenit 145 të KDM-së

Seanca ka qene e mbyllur për publikun dhe është zbatuar dispozita e nenit 50 te KDM-se

Trupi gjykues është në përbërje prej trupit gjykues për të mitur konform dispozitës së nenit 51 dhe nenit 152 par 2 të KDM-se.

Nga ekstrakti i lindjes i të dëmtuarit të mitur, M.I., me numër rendor E 0069/1999/BR, rezulton se i mituri ka lindur me dt. 25.5.1999, në R , R. K dhe se në kohën kur është kryer vepra penale nga i akuzuari, ka pas 15 vjet, 4 muaj, do të thotë ka qenë i mitur nën moshën 16 vjeçare.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të dt. 03.01.2015, i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij konform nenit 246 të KPP-së.

Pas leximit të aktakuzës, i akuzuari është njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë nga neni 248 par 1 të KPP-së, i cili është ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtorë për asnjërën vepër penale që i është vënë në barrë.

Konform nenit 245 par 6. të KPP-së, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar se para shqyrtimit të dytë duhet të veprojnë në kuptim të nenit 249 dhe 250 të KPP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit, me dt. 14.01.2015, ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës me arsyetim të cekur në kërkesë, të cilës kërkesë prokurorja e shtetit i është përgjigjur me shkrim me dt. 19.01.2015, të cilës kërkesë i ka bashkangjitur në kopje të mjaftueshme aktakuzën e re të ndryshuar, ku të akuzuarit sipas aktakuzës së re i janë vënë në barrë veprat penale nga dispozitivi i parë dhe i dytë i aktgjykimit.

Pas marrjes së aktakuzës së ndryshuar, bazuar në nenin 252 të KPP-së, është caktuar sërish shqyrtimi fillestar me dt. 02.02.2015, ku para se të lexohet aktakuza e ndryshuar, prokurorja e

shtetit ka bërë rregullimin e cilësimit juridik të veprës penale nga dispozitivi I. i saj, meqë ka vlerësuar se është bërë një gabim teknik, ku në vend të nenit 235 par.1, nënpar 1.4 të KP-së, duhet të jetë nga neni 235 par 1 nën par 1.1 të KP-së.

Pas leximit të aktakuzës së ndryshuar, i akuzuari është njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë bazuar në nenin 248 par 1 të KPP-së.

I akuzuari është deklaruar fajtor për veprën penale nga dispozitivi I. i akuzës, që i është vënë në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush, derisa veprën penale nga dispozitivi II. i aktakuzës së ndryshuar nuk e ka pranuar.

Gjykata ka marr mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të tij, në raport me veprën penale nga dispozitivi I. i akuzës, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Në vijim kryetarja e trupit gjykues për të mitur, duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit, për vepër penale nga dispozitivi I parë i aktakuzës së ndryshuar, ka gjetur se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi e ka kuptuar natyrën e veprës penale edhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka aprovuar.

Sa i përket veprës penale nga dispozitivi I. i akuzës, konform nenit 245 par 6. të KPP-së, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar se para shqyrtimit të dytë duhet të veprojnë në kuptim të nenit 249 dhe 250 të KPP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit, me dt. 13.02.2015. ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës, në raport me veprën penale nga dispozitivi II. i aktakuzës së ndryshuar me arsyetim të cekur në kërkesë, të cilës kërkesë prokurorja e shtetit i është përgjigjur me shkrim me dt. 25.02.2015, në të cilën ka kërkuar që të refuzohet kërkesa e mbrojtësit si e pabazuar, ndërsa propozimin për ekzaminim psikiatrik të të dëmtuarit A S nuk e ka kundërshtuar.

Me aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.258/14, të dt. 02.03.2015, është refuzuar kërkesa e mbrojtësit të të akuzuarit, për hudhje të aktakuzës, por është aprovuar propozimi për ekzaminim psikiatrik për të dëmtuarin A S, i cili me urdhëresë është dërguar në ekzaminim, në Qendrën Mendore në Pejë.

Me ekspertizën e dt. 11.03. 2015. të nënshkruar nga ekspertët Dr. S. K. psikolog dhe Dr. N. P. dhe M. H.- psikiatër, është dhënë mendimi se i dëmtuari A.S, vuan nga një sëmundje mendore kronike – “Retardio mentalis levis F70”, dhe i njëjti nuk është i aftë të kuptojë asnjë veprim të kryer ndaj tij.

Nga një kopje e ekspertizës ne seancën e shqyrtimit të dytë u është dorëzuar palëve të cilët nuk e kanë kundërshtuar.

Ne seancën e shqyrtimit gjyqësorë jopublike të dt 27.04.2015. i akuzuari ka mbet pranë deklaramit fajtor për veprën penale nga dispozitivi i I. i aktakuzës së ndryshuar, ndërsa sa i përket veprës penale nga dispozitivi II. i aktakuzës pasi e njëjta i është lexuar, të cilën është deklaruar se e ka kuptuar dhe pas njoftimit me pasojat e pranimit të fajësisë nga neni 248 par 1 të KPP-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë edhe për këtë vepër penale i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush,

Gjykata ka marr mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të tij, në raport me veprën penale nga dispozitivi i I. i akuzës, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Në vijim trupi gjykues për të mitur, duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit, për vepër penale nga dispozitivi i II. i aktakuzës së ndryshuar, ka gjetur se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi e ka kuptuar natyrën e veprës penale dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat, gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, për vepër penale, keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 235, par.1, nënpar.1.1, të KP-së, poashtu trupi gjykues për të mitur është njoftuar me pranimi e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale nga neni 235 par.1, pika 1.1, të KP-së, të cilin pranim e ka bërë në shqyrtimin fillestar, i aprovuar nga kryetarja e trupit gjykues për të mitur dhe për të dy veprat penale ka gjetur se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 1,pika 1.1 deri pikën 1.3 KPP-së, me konstatim se pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresa e lëndës, siç janë raporti i oficerit B. S., lidhur me incizimin e zërit, brenda lokalit të evidentuar si Peja 1, Peja 7 dhe Peja 10, të dt. 2.10.2014, raporti i lëshuar nga Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor në Gjakovë, dt. 16.10.2014, për të dëmtuarin A S, ekspertiza e Qendrës Mendore Pejë, e dt. 11.3.2015, fletëregjistrimi i MPB- Agjencia e regjistrimit civil e lëshuar në emër të miturit M.I. e dt. 29.5.2000, sms-et e fotokopjuara, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, CD-DVD me incizime 3 copë, dhe nuk ka gjetur se ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 248 par 1 pika 1.4, të KPPRK-së.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, gjykata konform nenit 326 par 4 të KPP-së, nuk ka bërë administrimin e provave, ka kaluar në fjalën përfundimtare.

Prokurorja e shtetit Valbona Haxhosaj, në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, e i cili pranim është i bazuar edhe në provat materiale, në bazë të cilave është ngritur aktakuza, duke mbet në tërësi pranë aktakuzës dhe përshkrimit juridik të saj, ka propozuar që të njëjtin ta shpalli fajtor, ta dënojë

sipas ligjit dhe ta obligojë në paguarjen e shpenzimeve procedurale ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ka propozuar që si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë si dhe gjendjen shëndetësore të akuzuarit, fakt që shihet edhe me sy të lirë.

Përfaqësuesi i ZMNV Demë Hasanaj, e ka përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit. Në emër të të dëmtuarit A.S, e ka parashtruar kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari A S, është pajtuar me fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të viktimave. Ka parashtruar kërkesën pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. G.K., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i mbrojturi i tij që në fillim e ka pranuar fajësinë për veprën e parë sipas aktakuzës, duke shpreh keqardhje për veprimet e tij, ndërsa pas ekspertizës së kryer për të dëmtuarin A S, prapë duke shpreh keqardhje për veprimet e tij, duke e pranuar fajësinë edhe për veprën penale nga dispozitivi i dytë i aktakuzës. Konsideron se si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit për dënimin duhet të merret mos dënueshmëria e të njëjtit, gjendjen e tij të rëndë shëndetësore, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese, të merr pranimin e fajësisë dhe të njëjtit ti shqiptojë një dënim nën minimumin e përgjithshëm të paraparë me ligj, ngase me një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit. Në të njëjtën kohë, ka propozuar që të akuzuarit ti vazhdohet masa e arrestit shtëpiak deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, pasi që të njëjtit i nevojitet një kujdes i veçantë nga ana e familjes.

I akuzuari S B: E ka përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, ndihet i penduar dhe i turpëruar.

Në bazë të pranimit të plotë të fajësisë të të akuzuarit S B, si dhe në bazë të deklaratave të të dëmtuarve dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive veprës penale keqpërdorim seksual i personave nën moshën 16 vjeçare, nga neni 235, par.1, nënpar.1.1, të KP-së dhe veprës penale keqpërdorim seksual i personave me çrregullime ose paaftësi mendore apo emocionale, nga neni 234 par.1, të KP-së, marr parasysh se veprat penale i ka kryer me dashje, e shpalli fajtor dhe e dënoi sipas ligjit, duke mos gjetur ndonjë arsye për zvogëlim të përgjegjësisë penale.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të akuzuarin S.B, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 73 par.1, të KP-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, ndërsa si rrethanë veçanërisht lehtësuese, bazuar në dispozitat ligjore të parapara me nenin 74 par 3 pika 3.10 dhe 3.11 lidhur me par 1, të KPRK-së, mori pranimin e fajësisë dhe faktin se ka shprehur keqardhje, andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqë bazuar në nenin 76 par 1 pika 1.2, për veprat penale për të cilat parashihet

minimumi i përgjithshëm i dënimit së paku 5 vjet, dënimi mund të zbutet deri në 3 vjet burgim, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet e parapara me neni 75 par 1 pika 1.2 të KPRK-së, në raport me veprën e par nga pika 1 e aktgjykimit. Ndërsa për veprën penale nga pika 2 e aktgjykimit pos rrethanave lehtësuese të cekura më lartë, nuk gjeti arsye për zbutje të dënimit meqenëse minimumi i përgjithshëm në raport me këtë vepër penale është një vit burgim,

Si rrethanë rënduese nuk gjeti meqenëse nga vet cilësimi juridik i të dy veprave penale, absorbohen mosha e të dëmtuarit të mitur dhe gjendja e të dëmtuarit A S.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73 par.1 të KPRK-së, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, ku në këtë rast ka aplikuar dispozitën e zbutjes së dënimit me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par 1, lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2, pika 2.1 2.2 dhe 2.6 , të KPP- së.

Vendimi për kompensimin e kërkesës pasurore-juridike është marrë konform dispozitës së nenit 463 par. 1, të KPP-së.

Vendimi për llogaritjen e arrestit shtëpiak në dënim, është marr konform nenit 83, të KP-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEPARTAMENTI PËR TË MITUR P.nr. 258/2014

Kryetarja e trupit gjykues për të mitur

Nushe Kuka Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate .